



BASHKIA E TIRANËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURIMEVE NJERËZORE

Lënda: Njoftim për vende të lira pune

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” , ligjit nr. 10112 datë 09.04.2009”Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”. Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.45 datë 06.07.2016 “Për ngritjen e Task-Forcës për rregjistrimin e Asambleve të Bashkëpronësisë dhe Administratorëve të Bashkëpronësisë”, Ligjit 136/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar”, Bashkia e Tiranës fton në konkurim për plotësimin e vendeve vakant të 70 (shtatëdhjetë) pozicioneve për stafin e Task Forcës si më poshtë:

1. **Koordinator Grupi (14)**
2. **Punonjës (56)**

Kandidatët duhet të jenë të kualifikuar sipas specifikimeve të mëposhtme:

- Të kenë arsim të lartë
- Të kenë njohuri të mira kompjuterike në programet bazë, Word, Exel, etj
- Të jenë i gatshëm për të punuar në grup dhe të ketë aftësi shumë të mira komunikuese.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i aplikantit
- b- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- c- Fotokopje të noterizuar diplomës
- d- Fotokopje të noterizuar të listës së notave
- e- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- g- Çertifikata kualifikimi (në rast se ka)
- h- Vlerësim pune nga punëdhënësi i fundit.

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në Bashkinë e Tiranës brenda datës **7 Nëntor 2016**.

Në datën **08 Nëntor 2016**, Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore në Bashkinë e Tiranës do të shpallë në faqen e internetit të Bashkisë dhe standat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e pozicionit datën, vendin dhe orën e zhvillimit të Intervistës.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me pozicionin të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia e Tiranës do ti njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail) dhe do të shpallë fituesit në faqen zyrtare dhe standat e informimit të publikut të Bashkisë së Tiranës.